



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:101984

Datë: 01.04.2022

Numri i dokumentit: 02873086

Ac.nr.5196/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Nora Dula-Bllaca, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q.D. nga fshati ..., Komuna e Malishevës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.K. avokat nga Malisheva, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, për kompensimin e ushqimit ditor, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.211/20, datë 07.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.03.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.211/20, datë 07.06.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.211/20, datë 07.06.2021, ka vendosur:

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Q.D. nga fshati ..., Komuna e Malishevës.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – DKAE që paditësit Q.D. nga fshati ..., Komuna e Malishevës në emër të shujtës ditore, për 553 ditë pune për periudhën nga data 18.04.2017 e deri 18.04.2020, të përlllogaritur sipas shumës prej 2 euro në ditë t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,106.00 euro, me kamatë prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi

datë 07.06.2021, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

III.DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 260 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj apo të njëjtin ta prish dhe çështjen lidhur me këtë kontest ta kthej në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën si të pabazuar dhe ta vërtetoj aktgjykimin e atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Q.D. nga fshati ..., Komuna e Malishevës me datë 29.07.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi për kompensimin e shujtës-ushqimit, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.211/20 të datës 07.06.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Q.D., duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas vlerësimit të të gjitha provave, veç e veç, e në lidhshmëri me njëra tjetrën ka gjetur se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura -në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët " Dëshmorët e Fshatit ..." në ..., por të njëjtit nuk i janë kompensuar mjetet në emër të shujtave ditore edhe pas kërkesës së paditësit për kompensimin e tyre për periudhën kontestuese. Ka shtuar se sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përkatësisht neni 35 par. 7 përcaktohet se : "*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim*". Më tej gjykata ka shtuar se meqenëse është vërtetuar fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, kërkesën lidhur me kompensimin në emër të shujtës ditore vendosi ta aprovoj për periudhën 18.04.2017-18.04.2020, përkatësisht për 553 ditë pune nga dy euro dhe e detyroi të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të

aktgjykimit të atakuar duke u bazuar në nenin 8 par. 1 dhe 245 të LMD-së. Ka arsyetuar se ka shqyrtuar edhe pretendimet e të autorizuarit të t'paditurës, por pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të cilën përkatësisht nenin 2 par 1.1 theksohet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”,* ndërsa në dispozitat e par. 1.2 theksohet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”.* Lidhur me kamatën gjykata ka vendosur konform nenit 382 par 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet procedurale konform nenit 452.1 të LPK-së dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t'paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Dëshmorët e Fshatit ...” në ..., Komuna e Malishevës, fakt ky i vërtetuar edhe në bazë të kontratës së punës me nr.protokollin 11/10, e datës. 30.09.2015, ndërsa prania e tij në punë vërtetohet në bazë të vërtetimit me numër protokollin 1/767 të dt. 002.06.2021, të lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Fshatit ...” në ..., Komuna e Malishevës, ku konstatohet se paditësi Q.D., ka gjithsejtë 553 ditë punë, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 18.04.2020, pra 185 ditë për një vit.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”.* Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”.* Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja*

Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes së të drejtës për parashtrim të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë si dhe shpenzimeve të udhëtimit, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë së paditësit.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësit për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, , për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Gjykata e Apelit e mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, mirëpo vlerëson se një pretendim i tillë është i pa bazuar. Dispozita nga neni 87 e Ligjit të Punës, Nr.03/L-212 parasheh që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.* Referuar kësaj dispozite, e duke u bazuar në faktin se nga data 18.04.2020 kur është bërë e arritshme kërkesa e fundit për kompensimin e ushqimit, e deri me dt. 29.07.2020 kur paditësi ka paraqitur padinë në gjykatë për realizimin e kësaj të drejte, nuk ka kaluar afati prej 3 vitesh i paraparë me dispozitën e lartcekur, andaj rrjedh se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, siç pretendohet nga pala e paditur.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës së paditur, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5196/2021 me datë 17.03.2022.

**Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka d.v.**